



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQËNIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

RAPORT

Shpërthim i gastroenteritit akut, Fushë Arrëz

04/09/2026

1. Përmbledhje

Më datë 31.08.2026, në sistemin SISI, në rubrikën “Ngjarje”, NJVKSH Pukë njoftoi për një rritje të rasteve me diarre akute pa gjak në qytetin e Fushë-Arrëzit. Në vijim të këtij njoftimi, më datë 01.09.2026, një grup pune i Institutit të Shëndetit Publik, u dërgua në terren për të vlerësuar nga afër situatën epidemiologjike dhe kushtet mjedisore në zonën e prekur, me vëmendje të veçantë ndaj sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.

Në periudhën 24.08.2026–02.09.2026, në Qendrën Shëndetësore Fushë-Arrëz janë regjistruar 139 raste me shenja gastrointestinale. Shumica e rasteve (128; 91.7%) kanë vendbanim në Fushë-Arrëz, me përqendrim të raportuar veçanërisht në Lagjen Demokracia dhe Lagjen Nushaj. Rasti tipik paraqitet me diarre dhe simptoma të sipërme gastrointestinale; 89.9% kanë raportuar të vjella dhe 71.5% temperaturë.

Rezultatet mikrobiologjike të ujit (Laboratori i Mikrobiologjisë së Ujrave, ISHP, 04.09.2026) konfirmojnë ndotjen e ujit të pijshëm përgjatë sistemit të furnizimit. Të gjitha mostrat klinike (17 tamponë rektalë) rezultuan negativë për patogjenët bakterialë dhe viralë të kërkuar. Situata epidemiologjike paraqet një tendencë në përmirësim, me paraqitjen e 5 rasteve të reja më datë 03.09.2026.

Duke marrë në konsideratë të dhënat mjedisore dhe epidemiologjike, përqendrimi i rasteve në një zonë urbane të furnizuar nga i njëjti sistem ujësjellësi, përfshirja e grupmoshave të ndryshme, dinamika dhe kohëzgjatja e kurbës epidemike, si dhe evidentimi i kontaminimit mikrobiologjik të ujit, përbëjnë një tregues të fortë për një burim të përbashkët ekspozimi të lidhur me sistemin e furnizimit me ujë.

2. Qëllimi i vlerësimit

Zona e vlerësuar, qyteti i Fushë-Arrëzit, ka një popullsi prej rreth 2,800 banorësh. Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i situatës epidemiologjike, identifikimi i faktorëve të mundshëm të ekspozimit dhe verifikimi i elementeve kryesore të sistemit të furnizimit me ujë, për të orientuar masat e kontrollit dhe hapat e mëtejshëm të hetimit

3. Veprimet e ndërmarra gjatë hetimit epidemiologjik

- U verifikua njoftimi dhe u përcaktua periudha kohore dhe shpërndarja hapësinore e rasteve.
- U identifikuan dhe u regjistruan rastet në line list.
- U mblodhën të dhëna epidemiologjike mbi konsumimin e ushqimeve dhe ujit, burimin e ujit të pijshëm, ushqimet e konsumuara, kontaktet me persona të sëmurë dhe ekspozime të tjera të mundshme.
- U vlerësua lidhja kohore dhe hapësinore ndërmjet rasteve, me qëllim evidentimin e një burimi të mundshëm të përbashkët.
- U verifikua prania e rasteve të ngjashme në familje, komunitet dhe në institucione të tjera të frekuentuara nga personat e prekur.
- Në datë 01.09.2026 u morën mostra klinike, përfshirë tampona rektalë nga personat me diarje, për ekzaminime mikrobiologjike dhe virologjike. U morën mostra të ujit në dy depot kryesore, në pika përfaqësuese të rrjetit dhe në pika fundore

4. GJETJET EPIDEMIOLOGJIKE

4.1 Shpërndarja e rasteve sipas vendbanimit

Gjatë periudhës 24.08.2026–03.09.2026, në Qendrën Shëndetësore Fushë-Arrëz janë paraqitur gjithsej 139 raste me shenja gastrointestinale. Nga hetimi paraprak rezulton se nuk kanë marrë pjesë në festa grumbullime të ndryshme gjatë kësaj periudhe. Lidhur me ushqimin referojnë konsumim ushqim shtëpie. Numri më i madh i rasteve të paraqitura i përket qytetit të Fushë-Arrëzit, me përqendrim veçanërisht në Lagjen Demokracia dhe Lagjen Nushaj.

Vendbanimi	Nr. rasteve	Përqindja
Fushë-Arrëz	128	91.7%
Kryezi	4	2.9%
Lumzi	1	0.74%
Kavlinë	1	0.74%
Shkodër	1	0.74%
Bicaj	1	0.74%
Breg	1	0.74%
Kalivare	1	0.74%
Tiranë	1	0.74%
Total	139	100%

Përqendrimi i 91.7% të rasteve në Fushë-Arrëz, dhe veçanërisht në dy lagje të qytetit, sugjeron nevojën për të hetuar ekspozimet e përbashkëta brenda kësaj zone

4.2. Karakteristikat demografike dhe klinike

Mosha e rasteve varion nga 2 deri në 94 vjeç, me moshë mesatare 37.3 vjeç. Nga 139 rastet, 78 (56.1%) janë femra dhe 61 (43.9%) meshkuj (raporti F:M = 1.46:1). Prekja e të gjitha grupmoshave, përfshirë fëmijët e vegjël dhe të moshuarit mbi 65 vjeç, është karakteristike për një ekspozim të përhapur në komunitet.


Karakteristika	Rezultati
Numri total i rasteve	139
Mosha	Mesatare 37.3 vjeç, ; min–maks 2–94 vjeç
Femra	78 (55.9%)
Meshkuj	61 (44.1%)
Vendbanim urban	128 (91.7%)
Vendbanim rural	11 (8.3%)
Diarre	139 (100%)
Të vjella	128 (92%)
Të përziera	10 (7.1%)
Temperaturë	81 (58.7%)
Shenja të tjera	5 (3.7%)

Sipas të dhënave të mbledhura, paraqitja klinike dominohet nga diarreja dhe të vjellat, me temperaturë përgjithësisht të ulët. Në materialin e hetimit raportohet se 40% e rasteve u paraqitën në të njëjtën ditë të fillimit të shenjave, 45.3% pas një dite dhe 12.6% pas dy ditësh.

4.3. Shpërndarja kohore e rasteve

Të dhënat tregojnë një rritje të dukshme të fluksit të rasteve në fund të periudhës së vëzhguar, me kulm të raportuar më 31.08.2026, kur të gjitha rastet e regjistruara atë ditë i përkisnin qytetit të Fushë-Arrëzit.

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas ditëve nga data 24.08 - 03.09.2026



4.4. Vlerësimi epidemiologjik i faktorëve të mundshëm të riskut

Gjatë hetimit u evidentua se furnizimi me ujë të pijshëm në zonën e prekur nuk është i vazhdueshëm. Banorët kanë referuar ndërprerje të furnizimit gjatë ditëve. Nga intervistimi paraprak i rasteve rezulton se rastet e intervistuara konsumojnë ujë të pijshëm nga rrjeti publik dhe furnizohen nga i njëjti sistem.

Rastet nuk kanë raportuar pjesëmarrje në festa ose grumbullime të ndryshme gjatë periudhës së ekspozimit dhe kanë referuar kryesisht konsumim të ushqimit të përgatitur në shtëpi.

4.5 Ekzaminimet laboratorike

Në kuadër të hetimit epidemiologjik nga ISHP u krye marrja e mostrave klinike nga rastet e dyshuara. Me date 01.09.2026 u morën gjithsej 17 tamponë rektale nga persona me shenja gastrointestinale të cilët u intervistuan. Mostrat e marra iu nënshtruan ekzaminimit bakteriologjik (kulturë) dhe testimit me metodë molekulare Multiplex RT_PCR për zbulimin e shkaktarëve viralë të gastroenteriteve (Norovirus, Rotavirus, Adenovirus, Astrovirus, Sapovirus). Të gjitha mostrat e testuara rezultuan negative. (Shtojca 2,3)

5. VLERËSIMI I SIGURISË SË FURNIZIMIT ME UJË

5.1 Takimi i përbashkët dhe informacioni i administruar

Në kuadër të vlerësimit u zhvillua një takim i përbashkët ndërmjet përfaqësuesve të ISHP-së, NJVKSH Pukë, Qendrës Shëndetësore Fushë-Arrëz dhe Ujësjiellësit. Në takim u shqyrtuan

informacionet e disponueshme për rastet e paraqitura për ndihmë shëndetësore, ecurinë e situatës epidemiologjike dhe mënyrën e funksionimit të sistemit të furnizimit me ujë.

Sipas informacionit të dhënë nga përfaqësuesit e Ujësjetës, sistemi furnizon me ujë rreth 2,800 banorë të qytetit të Fushë-Arrëzit, të shpërndarë në lagjet Dedaj, Tomaj, Ndokaj dhe Nushaj. U raportua se depot dhe linjat kryesore të furnizimit deri në hyrje të pallateve janë rehabilituar, ndërsa linjat e brendshme të shpërndarjes brenda pallateve vijojnë të jenë pjesë e rrjetit të vjetër.

Gjithashtu, u bë me dije se, për shkak të periudhës së zgjatur të thatësisë dhe temperaturave të larta, furnizimi me ujë është reduktuar dhe realizohet me orar, nga ora 05:00 deri në orën 23:00. Ndërprerja e furnizimit gjatë natës duhet të merret në konsideratë gjatë vlerësimit të funksionimit të rrjetit, veçanërisht për shkak të luhatjeve të mundshme të presionit gjatë ndërprerjes dhe rifillimit të furnizimit.

5.2 Përshkrimi i sistemit të furnizimit me ujë

Sistemi furnizohet nga dy burime, Micoj dhe Krrabi. Uji i ardhur nga këto burime grumbullohet fillimisht në Depon nr. 1, me kapacitet 500 m³. Prej saj, uji përcillet nëpërmjet linjës së transmetimit drejt Depos nr. 2, me kapacitet 800 m³. Në Depon nr. 2 kryhet procesi manual i klorinimit dhe më pas uji shpërndahet në rrjetin e qytetit, drejt objekteve, pallateve, familjeve dhe pikave fundore të furnizimit.

Skema e thjeshtuar e sistemit është: Burimi Micoj dhe Burimi Krrabi → Depoja nr. 1 (500 m³) → linja e transmetimit → Depoja nr. 2 (800 m³) → klorinimi manual → rrjeti shpërndarës i qytetit → pikat e konsumit dhe pikat fundore.

Skema e sistemit të furnizimit me ujë të qytetit të Fushë-Arrëzit




Figura 1. Skema e sistemit të furnizimit me ujë të qytetit të Fushë-Arrëzit.

5.3. Konstatimet gjatë verifikimit në terren

Gjatë verifikimit u konstatua se të dyja depot ndodheshin në zona të pozicionuara mbi qytet. Territoret e tyre ishin të rrethuara, të sistemuara me platforma të rregullta dhe ruheshin nga personel përgjegjës. Në afërsi të depove nuk u evidentuan ndërtesa ose veprimtari që, nga vrojtimi i drejtpërdrejtë, të përbënin burim të dukshëm ndotjeje.

Megjithëse depot dhe linjat kryesore deri në hyrje të pallateve rezultojnë të rehabilituara sipas informacionit të Ujësjiellësit, prania e linjave të vjetra brenda pallateve përbën një element që duhet përfshirë në verifikimet e mëtejshme teknike dhe higjieno-sanitare, veçanërisht në rastet e rrjedhjeve, presionit të ulët ose ndërprerjeve të furnizimit.

5.4 . Marrja e mostrave të ujit

Pas verifikimit të sistemit dhe shqyrtimit të të dhënave të marra në takimin e përbashkët, grupi realizoi marrjen e mostrave të ujit në dy depot kryesore, në pika përfaqësuese të rrjetit dhe në pika fundore. Përzgjedhja synoi vlerësimin e cilësisë së ujit nga faza e grumbullimit dhe dezinfektimit deri në pikat fundore të furnizimit.

Tabela e mëposhtme paraqet pikat e monitorimit

Mostra	Pika e marrjes	Pozicioni në sistem
1	Depo nr. 2	Pika ku kryhet klorinimi manual
2	Depo nr. 1	Depoja e furnizuar nga burimet Micoj dhe Krrabi
3	Qendra Shëndetësore Fushë-Arrëz	Pikë fundore/përfaqësuese e rrjetit
4	Familje, Pallati nr. 33	Pikë fundore në pallat
5	Bar-Kafe “Dardania”	Pikë fundore në rrjet
6	Bufe “Kryeziu”	Pikë fundore në rrjet
7	Pallati nr. 14	Pikë fundore në pallat
8	Ish-Parku	Pikë fundore e rrjetit

5.5 Ruajtja, transportimi dhe analizimi i mostrave

Mostrat u identifikuan dhe u transportuan sipas kushteve të përcaktuara për marrjen, ruajtjen dhe transportimin e mostrave të ujit. Ato u vendosën në termoboks të pajisur me pllaka akulli dhe u ruajtën gjatë transportit në intervalin e temperaturës 2–8°C.

Mostrat u dërguan në laborator për analizimin e parametrave mikrobiologjikë të ndotjes dhe të parametrave fiziko-kimikë. Interpretimi përfundimtar i cilësisë së ujit dhe vlerësimi i lidhjes së mundshme me situatën epidemiologjike do të kryhen pas administrimit të rezultateve laboratorike dhe analizimit të tyre së bashku me të dhënat e rasteve.

5.6 Rezultatet e analizave laboratorike

Konkluzione analitike:

Nga analizat laboratorike të mostrave së ujit të sistemit të furnizimit me ujë në Fushë Arrëz, (shih Shtojca 1, Tabela a), rezulton se:

Aspekti mikrobiologjik: Nga analiza e mostrave të ujit të Bashkisë Fushë Arrëz rezulton se:

M₁ – Depo klorinimi Nr. 2, Fushë-Arrëz, konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesin Coliform bacteria në vlerën 1/100 ml ujë krahasuar me normën 0/100 ml ujë.

M₂ – Depo Nr. 1 linja Micaj, Fushë-Arrëz, konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit Coliform bacteria në vlerën 236/100 ml ujë; Escherichia coli (E.coli) 34/100 ml ujë, Enterococci 2/100 ml ujë krahasuar me normën 0/100 ml ujë.

M₃ – Qendra Shëndetësore, Fushë-Arrëz, rezulton se nuk konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit e analizuar.

M₄ – Familje pallati 33, Fushë-Arrëz, konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit Coliform bacteria në vlerën 160/100 ml ujë; Escherichia coli (E.coli) 3/100 ml ujë, Enterococci 0/100 ml ujë krahasuar me normën 0/100 ml ujë.

M₅ – Bar-Kafe Dardania, Fushë-Arrëz, konstatohet se nuk konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit e analizuar.

M₆ – Buqe Kryqëzimi, Fushë-Arrëz, konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit Coliform bacteria në vlerën 9/100 ml ujë, krahasuar me normën 0/100 ml ujë.

M₇ – Pallati 14, Fushë-Arrëz, konstatohet se nuk konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit e analizuar.

M₈ – Pikë fundore (ish parku, përballë çesme publike), Fushë-Arrëz, konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit Coliform bacteria në vlerën 340/100 ml ujë; Escherichia coli (E.coli) 65/100 ml ujë; Enterococci 10/100 ml ujë dhe Pseudomonas aeruginosa 7/100 ml ujë krahasuar me normën 0/100 ml ujë.

Aspekti fiziko-kimik: Nga analizat laboratorike fiziko kimike të mostrave së ujit të sistemit të furnizimit me ujë në Fushë Arrës, rezulton se: nuk konstatohet prania e turbullirës. Organoleptikisht, uji paraqet shije, erë dhe ngjyrë normale. Treguesit e tjerë fiziko-kimikë rezultojnë në normë. (Shtojca 1, tabela b)

6. REKOMANDIME

6.1 Rekomandime për kontrollin dhe monitorimin e ujit

- Kryerja e një kontrolli të përbashkët nga Ujësjiellësi dhe NJVKSH Pukë përgjatë të gjithë sistemit, duke përfshirë burimet, linjat e transmetimit, depot, pikën e dezinfektimit, rrjetin shpërndarës dhe pikat fundore, për evidentimin e çdo faktori të mundshëm që mund të ndikojë në cilësinë e ujit.
- Ujësjiellës-Kanalizime Pukë të kryejë verifikimin e gjendjes teknike dhe higjieno-sanitare të depove, kapakëve, pikave të ajrimit, linjave, nyjeve dhe lidhjeve të rrjetit, me vëmendje ndaj infiltrimeve, rrjedhjeve, uljes së presionit, ndërprerjeve të furnizimit dhe kontakteve të mundshme me burime ndotjeje.

- Referuar VKM 379, datë 25.05.2016 për Miratimin e Rregullores “Cilësia e Ujit të Pijshëm”, Ujësjiellës-Kanalizime Pukë të informojë popullatën mbi situatën e furnizimit me ujë.
- Ujësjiellës-Kanalizime Pukë të kryejë pastrimin dhe dezinfektimin e plotë të depove, linjave të furnizimit dhe pjesëve të tjera të sistemit, sipas procedurave teknike dhe sanitare në fuqi.(Shtojca VII).
- Ujësjiellës-Kanalizime Pukë të intensifikojë kujdesin në procesin manual të klorinimit, duke garantuar dozimin e kontrolluar, vazhdimësinë e dezinfektimit dhe mbajtjen e evidencave për sasinë e dezinfektantit, kohën e aplikimit dhe matjet e kryera.
- NJVKSH Pukë të kryejë monitorimin sistematik i klorit mbetës në dalje të Depos nr. 2, në pika të ndërmjetme dhe në të gjitha pikat fundore, me qëllim që vlerat të jenë në përputhje me kërkesat parametrike të VKM nr. 379, datë 25.05.2016, “Për miratimin e rregullores ‘Cilësia e ujit të pijshëm’”.
- NJVKSH Pukë të shtojë pikat dhe shpeshtësinë e monitorimit, veçanërisht në zonat fundore, në pallatet me linja të brendshme të vjetra dhe në zonat ku mund të evidentohen presion i ulët ose furnizim me ndërprerje.
- Komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet Ujësjiellësit dhe NJVKSH Pukë për rezultatet e klorit mbetës dhe treguesit e tjerë mikrobiologjikë e fiziko-kimikë të analizuar.
- Në rast të rezultateve jokonforme, marrja pa vonesë e masave korrigjuese, përsëritja e pastrimit dhe dezinfektimit, si dhe rimarrja e mostrave për të verifikuar efektivitetin e ndërhyrjeve.
- Zbatimi me korrektësi i kërkesave të VKM nr. 379, datë 25.05.2016, nga të gjitha strukturat përgjegjëse për trajtimin, kontrollin dhe shpërndarjen e ujit të destinuar për konsum njerëzor.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet NJVKSH Pukë, Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, ISHSH-së, Ujësjiellësit dhe pushtetit vendor, për shkëmbimin në kohë të informacionit dhe koordinimin e masave të nevojshme.
- Të sigurohet komunikimi dhe koordinimi ndërinstitucional, veçanërisht ndërmjet ISHSH dhe pushtetit vendor, për adresimin në kohë dhe në mënyrë efektive të problematikave të evidentuara.
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) të ndërmarrë masa konkrete dhe të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet përkatëse, me qëllim përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë të pijshëm.
- Në lidhje me situatën e furnizimit me ujë në qytetin e Fushë Arrëzit, ISHSH dhe NjVKSh Pukë, në përputhje me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e Rregullores ‘Cilësia e Ujit të Pijshëm’”, të forcojnë bashkëpunimin dhe koordinimin me Bashkinë Fushë Arrëz, për mundësimin e alternativave të sigurt të furnizimit me ujë deri në përmirësimin e situatës.
- Ujësjiellës-Kanalizime Pukë të sigurojë zbatimin korrekt dhe funksionimin e pandërprerë të sistemit të klorinimit, duke garantuar operim të sigurt dhe efikas.
- Të kryhet dozimi i klorit në përputhje me normat e përcaktuara nga standardet përkatëse. Duke qenë se praktika aktuale e dezinfektimit nuk garanton shpërndarje uniforme të klorit, kërkohet që procesi i klorinimit të realizohet duke filluar nga depoja e ujit dhe të sigurohet vazhdimësia e tij deri në pikën fundore të furnizimit.

- NJVKSh Pukë dhe Ujësjiellës-Kanalizime Pukë, në cilësinë e institucioneve përgjegjëse për monitorimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së ujit, të sigurojnë zbatimin dhe monitorimin e rregullt të procesit të dezinfektimit të ujit të pijshëm, përfshirë kryerjen sistematike të testeve për vlerësimin e klorit aktiv.
- Ujësjiellës-Kanalizime Pukë përpara përdorimit të çdo sasi të lëndës kimike për dezinfektimin e ujit, duhet të analizojë dhe të verifikojë përqindjen e klorit aktiv. Ky verifikim duhet të kryhet përpara përdorimit të lëndës, me qëllim garantimin e cilësisë së produktit, përcaktimin e saktë të dozimit dhe sigurimin e efektivitetit të procesit të dezinfektimit të ujit të pijshëm.

6.2. Rekomandime në kuadër të survejancës epidemiologjike

- Të vijojë monitorimi epidemiologjik aktiv i rasteve me diarre, të vjella, dhimbje abdominale dhe temperaturë, me përditësim ditor të numrit të rasteve, vendbanimit, moshës, datës së fillimit të simptomave dhe ekspozimeve të mundshme.
- Të kryhet hetim epidemiologjik i detajuar, veçanërisht për rastet nga dy lagjet e Fushë-Arrëzit me numrin më të lartë të rasteve (Lagja Demokracia dhe Lagja Nushaj), për të identifikuar nëse ekziston një burim i përbashkët ekspozimi.
- Të hetohen burimet e mundshme ushqimore, veçanërisht ushqimet e konsumuara jashtë shtëpisë, aktivitetet tregtare, subjektet e shërbimit ushqimor, produktet e përgatitura paraprakisht dhe ushqimet e ruajtura në temperatura të papërshtatshme.
- Të rekomandohet marrja e mostrave klinike për ekzaminim laboratorik, sidomos nga rastet me simptoma më të rënda, raste të reja ose raste që lidhen epidemiologjikisht, për identifikimin e mundshëm të një agjenti etiologjik.
- Të monitorohen veçanërisht rastet e rënda dhe grupet vulnerabël, duke siguruar referimin në nivele më të larta të kujdesit shëndetësor kur ka shenja dehidratimi të rëndë, gjendje të përgjithshme të rënduar, gjak në feçe ose komplikacione të tjera.
- Në kuadër të masave të përgjithshme parandaluese, rekomandohet forcimi i praktikave të higjienës personale, përdorimi i ujit të sigurt për konsum dhe përgatitjen e ushqimit. Këto masa rekomandohen si pjesë e parandalimit të infeksioneve gastrointestinale, ndërkohë që vijon monitorimi i cilësisë së ujit dhe hetimi epidemiologjik për identifikimin e faktorëve të mundshëm të ekspozimit.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet NJVKSH Pukë, Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, ISHP, ISHSH-së, Ujësjiellësit dhe pushtetit vendor, për shkëmbimin në kohë të informacionit dhe koordinimin e masave të nevojshme.

7. Hapat e metejshëm

Veprimi	Përgjegjësit kryesorë	Afati i rekomanduar
Përditësimi i line list-it dhe kurbës epidemike	NJVKSH Pukë / QSH Fushë-Arrëz / ISHP	Në vijimësi, çdo ditë

Monitorim i rasteve të reja dhe i klorit të mbetur; raportim ditor	NJVKSH Pukë	Ditore
Verifikimi teknik dhe higjieno-sanitar i rrjetit	Ujësjiellësi / NJVKSH Pukë / ISHSH	Sa më shpejt
Raportim i përditësuar i situatës	NJVKSH Pukë / ISHP	Sipas ecures së situatës

8. PËRFUNDIM

Duke marrë në konsideratë të dhënat mjedisore dhe epidemiologjike, përqendrimi i rasteve në një zonë urbane të furnizuar nga i njëjti sistem ujësjiellësi, përfshirja e grupmoshave të ndryshme, dinamika dhe kohëzgjatja e kurbës epidemike, si dhe evidentimi i kontaminimit mikrobiologjik të ujit, përbëjnë një tregues të fortë për një burim të përbashkët ekspozimi të lidhur me sistemin e furnizimit me ujë.

Në përfundim, të dhënat epidemiologjike dhe mjedisore të disponueshme mbështesin klasifikimin e ngjarjes si shpërthim me transmetim hidrik, si pasojë e moszbatimit korrekt të praktikave higjieno-sanitare që garantojnë cilësinë dhe sigurinë e ujit të pijshëm.

SHTOJCA 1. REZULTATET E FIZIKO-KIMIKE DHE MIKROBIOLOGJIKE TE MOSTRAVE TE UJIT

Enti dërgues: Njësia Vendore e kujdesit Shëndetësor Pukë,
Adresa:
Marrësi i mostrës: Sektori Uji dhe Saniteti.
Lloji i analizës: Mikrobiologji dhe Fiziko kimike.

Kodimi i mostrave: M₁ – Depo klorinimi Nr. 2, Fushë-Arrëz;
M₂ – Depo Nr. 1 linja Micaj, Fushë-Arrëz;
M₃ – Qendra Shëndetësore, Fushë-Arrëz;
M₄ – Familje pallati 33, Fushë-Arrëz;
M₅ – Bar-Kafe Dardania, Fushë-Arrëz;
M₆ – Bufe Kryqëzimi, Fushë-Arrëz;
M₇ – Pallati 14, Fushë-Arrëz;
M₈ – Pikë fundore (ish parku), Fushë-Arrëz;

Dt: 01.09.2026

a. Analizat mikrobiologjike:

Nr	Indeksi mikrobiologjik	Temp. Inkub. °C	Rezultati								Vlera Parametrike	Metoda e analizës
			M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8		
1	Coliform bacteria	37	1	236	0	160	0	9	0	340	0/100 ml ujë	ISO 9308-3
2	Escherichia coli (E.coli)	44	0	34	0	3	0	0	0	65	0/100 ml ujë	ISO 9308-3
3	Enterococci	44	0	2	0	0	0	0	0	10	0/100 ml ujë	ISO 7899-2

4	Pseudomonas aeruginosa	37	0	0	0	0	0	0	0	7	0/100 ml ujë	ISO 16266:2008
---	------------------------	----	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------	-------------------

b. Analizat Fiziko kimike:

Nr	Parametri	Rezultati								Vlera Parametrike	Njësia	Metoda e Përcaktimit
		M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8			
1	Shija	N	N	N	N	N	N	N	N	E pranueshme për konsumatorin dhe pa ndryshime jonormale		
2	Aroma	N	N	N	N	N	N	N	N	E pranueshme për konsumatorin dhe pa ndryshime jonormale		
3	Ngjyra	N	N	N	N	N	N	N	N	Pa ndryshime jonormale		
4	Turbullira	0	0	0	0	0	0	0	0	E pranueshme për konsumatorin dhe pa ndryshime jonormale		S SH ISO 7027
5	Përqëndrimi i joneve të hidrogjenit (pH)	7.72	7.87	7.9	7.97	7.96	7.97	7.98	7.38	6.5 - 9.5	pH njësi	S SH ISO 10523
6	Përcjellshmëria	187	186	186	188	185	182	186	271	2500	$\mu S\ cm^{-1}$ në 20°C	S SH ISO 7888
7	Amonium	0	0	0.038	0	0	0	0	0	0.1	mg/l	S SHISO 7150
8	Nitrite (NO ₂)	0	0	0	0	0	0	0	0	0.5	mg/l	S SH ISO 6777
9	Nitrate (NO ₃)	0.44	0.44	0.44	0.44	0.44	0.44	0.44	2.2	50	mg/l	Metoda me brucinë
10	Fortësia	6.44	6.3	6.16	6.3	5.6	5.6	5.88	7.42	10-20	°dH	S SHISO 6059
11	Oksidueshmëria	1.04	1.048	1.032	1.048	1.04	1.048	1.04	1.04	5.0	mg/l O ₂	S SHISO EN 8467
12	Kloruret	14.184	14.184	14.184	14.184	14.184	14.184	14.184	24.822	250	mg/l	S SH ISO 9297
13	Sulfatet	1	2	1	1	1	2	2	9	250	mg/l	Metoda me klorur bariumi
14	Magnez	21.888	21.28	21.28	22.496	21.28	19.456	21.28	13.376	50	mg/l	S SH 2639-4
15	Kalçiumi	10.04	10.04	9.018	8.016	5.01	8.016	7.014	31.062	200	mg/l	S SH ISO 6058

Shënim: Raport Analiza vlen vetëm për mostrën/at e sjellë/a dhe të analizuar/a në laboratorë.

Normat e paraqitura në tabelë i referohen Standartit Aktual Shqiptar, VKM 379, datë 25.05.2016 për Miratimin e Rregullores “Cilësia e Ujit të Pijshëm”.

Lloji i mostrës: Hipoklorit Natriumi.

Nr.	Indekset Analitike	Rezultati i mostrës së analizuar	Limiti (në mg/kg)	Metoda e Vlerësimit
HIPOKLORITI I NATRIUMIT (mg/kg të klorit aktiv)				
1	Ngjyra dhe era	Solucion i kthjellët nga i verdhë në të gjelbër, me erë të lehtë klori.		S SH EN 901:2007

2	Klori aktiv	9.04	13-15% (m/m)	S SH EN 901:2007
---	-------------	------	--------------	------------------

Nga analiza e kryer sipas standardit SSH EN 901:2007, rezulton se përmbajtja e klorit aktiv është 9,04% (m/m), ndërkohë që kufiri i përcaktuar është 13–15% (m/m). Për rrjedhojë, përqindja e klorit aktiv rezulton nën kufirin minimal të kërkuar dhe nuk përmbush kërkesat e përcaktuara për përdorimin e tij në procesin e klorinimit dhe dezinfektimit të ujit të pijshëm.

Konkluzione analitike:

Nga analizat laboratorike të mostrave së ujit të sistemit të furnizimit me ujë në Fushë Arrës, (shih Tabela a), rezulton se:

Aspekti mikrobiologjik: Nga analiza e mostrave të ujit të Bashkisë Fushë Arrës rezulton se:

M₁ – Depo klorinimi Nr. 2, Fushë-Arrës, konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesin Coliform bacteria në vlerën 1/100 ml ujë krahasuar me normën 0/100 ml ujë.

M₂ – Depo Nr. 1 linja Micaj, Fushë-Arrës, konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit Coliform bacteria në vlerën 236/100 ml ujë; Escherichia coli (E.coli) 34/100 ml ujë, Enterococci 2/100 ml ujë krahasuar me normën 0/100 ml ujë.

M₃ – Qendra Shëndetësore, Fushë-Arrës, rezulton se nuk konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit e analizuar.

M₄ – Familje pallati 33, Fushë-Arrës, konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit Coliform bacteria në vlerën 160/100 ml ujë; Escherichia coli (E.coli) 3/100 ml ujë, Enterococci 0/100 ml ujë krahasuar me normën 0/100 ml ujë.

M₅ – Bar-Kafe Dardania, Fushë-Arrës, konstatohet se nuk konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit e analizuar.

M₆ – Buqe Kryqëzimi, Fushë-Arrës, konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit Coliform bacteria në vlerën 9/100 ml ujë, krahasuar me normën 0/100 ml ujë.

M₇ – Pallati 14, Fushë-Arrës, konstatohet se nuk konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit e analizuar.

M₈ – Pikë fundore (ish parku, përballë çesme publike), Fushë-Arrës, konstatohet prania e ndotjes mikrobiologjike për treguesit Coliform bacteria në vlerën 340/100 ml ujë; Escherichia coli (E.coli) 65/100 ml ujë; Enterococci 10/100 ml ujë dhe Pseudomonas aeruginosa 7/100 ml ujë krahasuar me normën 0/100 ml ujë.

Aspekti fiziko-kimik: Nga analizat laboratorike fiziko kimike të mostrave së ujit të sistemit të furnizimit me ujë në Fushë Arrës, rezulton se: nuk konstatohet prania e turbullirës. Organoleptikisht, uji paraqet shije, erë dhe ngjyrë normale. Treguesit e tjerë fiziko-kimikë rezultojnë në normë. (shih **tabelën b**) më sipër me rezultatet analitike fiziko-kimike)

SHTOJCA 2. EKZAMINIMI BAKTERIOLOGJIK

Tiranë më: 04/09/2026

PËRGJIGJE EKZAMINIMI.

Nga ekzaminimi bakteriologjik i mostrave të marra në vatër në Fushë Arrës në datën 01.09.2026 kanë rezultuar:

Nr	Mosha	Data e marrjes së mostrës	Kulturë feçe
1	19	1.09.2026	Negative
2	51	1.09.2026	Negative
3	5	1.09.2026	Negative
4	82	1.09.2026	Negative
5	21	1.09.2026	Negative
6	58	1.09.2026	Negative
7	51	1.09.2026	Negative
8	21	1.09.2026	Negative
9	61	1.09.2026	Negative
10	63	1.09.2026	Negative
11	23	1.09.2026	Negative
12	38	1.09.2026	Negative
13	51	1.09.2026	Negative
14	58	1.09.2026	Negative
15	14	1.09.2026	Negative
16	12	1.09.2026	Negative
17	49	1.09.2026	Negative

SHTOJCA 3 . EKZAMINIMI VIROLOGJIK

Tiranë më: 03/09/2026

PËRGJIGJE EKZAMINIMI.

Nga testimi me metodë molekulare Multiplex RT_PCR , i mostrave klinike (tampon rektal) të marra në vatër në Fushë Arrëz me qëllim zbulimin e agjentëve virale si shkaktarë të gastroenteriteve (Norovirus, Rotavirus, Adenovirus, Astrovirus, Sapovirus) në datën 01.09.2026 kanë rezultuar:

Nr	Mosha	Data e marrjes së mostrës	REZULTATI
1	19	1.09.2026	Negative
2	51	1.09.2026	Negative
3	5	1.09.2026	Negative
4	82	1.09.2026	Negative
5	21	1.09.2026	Negative
6	58	1.09.2026	Negative
7	51	1.09.2026	Negative
8	21	1.09.2026	Negative
9	61	1.09.2026	Negative
10	63	1.09.2026	Negative
11	23	1.09.2026	Negative
12	38	1.09.2026	Negative
13	51	1.09.2026	Negative
14	58	1.09.2026	Negative
15	14	1.09.2026	Negative
16	12	1.09.2026	Negative
17	49	1.09.2026	Negative